

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Kryeinspektor

26 prill 2022

Të nderuara familje të Rrethit Shkollor të Filadelfias,


Sot, Rrethi Shkollor i Filadelfias është duke nxjerrë faqen interaktive të internetit për [Procesin e Planifikimit të Komplekseve \(Facilities Planning Process, FPP\)](#).

Kjo faqe interneti, <http://www.philasdfacilities.info>, përmban një hartë interaktive mund të gjeni informacion për gjendjen e çdo ndërtese të shkollës që administrohet nga Rrethi Shkollor: analiza të gjendjes fizike të çdo ndërtese, vlerësime se sa i përshtatshëm është çdo kompleks për mësimdhënie dhe për të mësuar, si dhe vlerësime për përdorimin e çdo ndërtese për aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore. Në faqen e internetit do të gjeni video të shkurtra informative që shpjegojnë se si janë mbledhur këto të dhëna dhe si do të përdoren.

Gjatë muajit maj, do të keni mundësinë të mësoni më shumë për procesin FPP, si dhe për të gjitha mjetet e dobishme në faqen e internetit, duke ndjekur një nga Bisedat e Komunitetit virtuale të Rrethit Shkollor. Sesionet specifike do të bëhen në spanjisht, dhe shërbime të tjera përkthimi janë në dispozicion duke marrë masa paraprakisht. Regjistrohuni dhe merrni pjesë në një ose më shumë takime [këtu](#).

Ju falënderojmë paraprakisht që përfshiheni në këtë proces të rëndësishëm.

Me respekt,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Kryeinspektor
Rrethi Shkollor i Filadelfias